



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3004/2 Prot.

Rrëshen më, 05 . 10 . 2020

V E N D I M

Nr. 86 datë 30.09.2020

PËR

**NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS NGA “MAJA E MOLLZES” NË RRUGA
“REÇ”, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, 4601, BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, pika 1/1.7. shkronja “b” e nenit 54, shkronja “ll” e nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pikave 1, 3 dhe 4 të nenit 1/1, nenit 3 të ligjit nr 9270 datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” (të ndryshuar), shkronja “dh” të pikës nr. 2 të nenit nr. 11 të ligjit nr. Nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në kërkesën nr. 2396 prot, datë 04.08.2020 të banorëve të lagjes Reç, bashkëlidhur projekt-vendimit të paraqitur nga kryetari i bashkisë në këshillin bashkiak, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak në seancë;

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimin e emërtimit të rrugës nga rruga “Maja e Mollzes”, në rruga “Reç”, në fshatin Fushë - Lumth, qyteti Rrëshen, njësia administrative Rrëshen, kodi postal 4601, bashkia Mirditë.
 - Rruga fillon nga nyja e rrugës “At Gjergj Fishta” pallati nr. 43 (parafabrikat) dhe përfundon në ndërtesën nr. 40 të rrugës “Maja e Mollzes”, e ndryshuar me togfjalëshin “Reç”.
 - Rruga përfshinë të gjitha degëzimet në ndërtesat ekzistuese dhe shtrihet në një gjatësi prej 1015 ml.
 - Planvendosja e rrugës në Shkallë Sh 1: 2 500, pjesë e këtij vendimi bashkëlidhur.
2. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të zbatojë procedurën për ndryshimin e emërtimit në Gjeoportalin ASIG dhe në Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA) sistemi Adresari.
3. Çdo vendim i mëparshëm që bie ndesh me parashikimet e pikës 1 të këtij vendimi shfuqizohet.

4. Ngarkohet kryetari i bashkisë, (drejtoria e planifikimit, zhvillimit të territorit dhe strehimit), për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"(të ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gasper TOPOLLAJ



KRYETAR

Pjeter PJETRI